



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Shtator 2016

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Tetor

Nëntor

Dhjetor

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Shtator 2016

© Ministria e Financave, 2016

Drejtoria e Makroekonomisë dhe Statistikave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 3, Tiranë

www.financa.gov.al

E-mail: eva.doda@financa.gov.al
vivi.besho@financa.gov.al

Përmbajtja

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR	13

Veçoritë Kryesore

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin shtator 2016 arriti në 101.5 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin shtator 2016 ishte 1.8 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin shtator 2016 ishte 122.50 lekë për dollarë dhe 137.34 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit shtator 2016 shënuan kuotat 0.72 për qind për ato 12-mujore, 0.54 për qind për 6-mujoret ,0.27 për qind për depozitat 3-mujore dhe 0.79 për qind për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 13.18 për qind për huatë 12-mujore dhe 10.04 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,230,848.7 milionë lekë në muajin shtator , duke shënuar një rritje prej rreth 2.7 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i përgjithshëm i pagesave* për tremujorin e dytë të 2016-ës shënoi rritje të mjeteve valutore (rezervës), duke shënuar vlerën 0.
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-shtator 2016 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej rreth 10.5 miliardë lekë, që do të thotë se janë mbledhur rreth 5.8 miliardë lekë më shumë se planifikimi për këtë periudhë (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 4.6 miliardë lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-shtator 2016, arritën në rreth 298.4 miliardë lekë ose afërsisht 99 për qind e planit për muajin shtator.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 287.9 miliardë lekë ose 97 për qind e shpenzimeve të planifikuara për muajin shtator.


Zhvillimet Ekonomike

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Inflacioni vjetor për muajin shtator 2016 ishte +1.8 %. Një vit më parë ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit ishte 2.2%.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin shtator 2016 shënoi rritje prej 0.4 për qind krahasuar me muajin paraardhës. Ky indeks ka shënuar rritje prej 0.86 në muajin gusht dhe rritje prej 0.05 për qind në muajin korrik. Në të njëjtën periudhë të një viti më parë, Indeksi I Çmimeve të Konsumit shënoi rritje prej 0.6 për qind në muajin shtator dhe 0.77 për qind në muajin gusht ndërsa shënoi rënie prej 0.67 për qind në korrik 2015.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët patën kontributin më të lartë në inflacionin e përgjithshëm ishin: *“Ushqime dhe pije jo alkoolike”* me një rritje vjetore të çmimit prej **+3.7%**, duke kontribuar me **+1.35** pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm; *“Shërbimi arsimor”* me një rritje vjetore të çmimit prej **+3.8%**, duke kontribuar me **+0.15** pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm; *“Mallra dhe shërbime të ndryshme”* me një rritje vjetore të çmimit prej **+2.9%**, duke kontribuar me **+0.13** pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm. Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, ato të cilët



patën kontributin më të ulët në inflacionin e përgjithshëm ishin: *“Transport”* me një rritje vjetore të çmimit prej **-1.7%**, duke kontribuar me **-0.11** pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm; *“Shëndeti”* me një rritje vjetore të çmimit prej **-0.2%**, duke kontribuar me **-0.01** pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm.

Ndryshimi mujor i indeksit është 0.3%. Krahasuar me muajin gusht 2016, rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin *“Mallra dhe shërbime të ndryshme”* me 2,9 %. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së tarifave të sigurimit të automjeteve.


Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2015	1.3	2.3	2.2	2.3	1.8	1.4	1.3	1.9	2.2	2.1	2.1	2.0
2016	1.5	0.2	0.3	0.3	0.7	1.2	1.9	2.0	1.8			

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin shtator 2016, arriti në 137.34 lekë/euro, duke shënuar rritje në vlerë me 0.6 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit shtator, një euro u këmbye me 137.33 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin shtator 2016 arriti në 122.50 lekë/dollarë duke shënuar rritje me 0.6 për qind kundrejt muajit gusht 2016. Në fund të muajit shtator, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 122.74 lekë/dollarë.

Në krahasim me muajin shtator të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 1.4 për qind, ndërsa kundrejt monedhës evropiane rezulton se është nënçmuar në masën 1.6 për qind. Nënçmimi i lekut kundrejt monedhës amerikane dhe evropiane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar.



Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan, pësoi një rritje mesatare rreth 0.9 dollarë/euro duke ruajtur të njëjtin nivel të muajit të mëparshëm. Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave


Gjatë muajit shtator 2016, normat e interesit të depozitave 12 dhe 6-mujore në lekë arritën kuotën e 0.72 dhe 0.54 për qind duke shënuar respektivisht rritje prej 0.18 dhe rënie 0.13 pikë përqindje krahasuar me muajin gusht 2016. Normat e interesit të depozitave me afat të maturimit 3-mujore kanë shënuar rënie duke arritur kuotën 0.27 për qind, ndërsa ato me afat maturimi 1-mujore shënuan rritje prej 0.22 pikë përqindje.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat maturimi 12, 6, 3 dhe 1-mujore. Rënia më e madhe prej 0.55 pikë përqindje është shënuar nga depozitat me afat të maturimit 12-mujor që kanë arritur nivelin 0.72 për qind për shtator 2016, pasuar nga depozitat me afat të maturimit 1-mujor me rënie vjetore prej 0.53 pikë përqindje.

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit shtator 2016 shënoi rritje me 5.46 pikë përqindje krahasuar me muajin gusht 2016, duke arritur në nivelin 13.18 për qind. Norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi rënie me 1.00 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë duke arritur nivelin 10.04 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit shtator 2016, për bonot 12 dhe 6-mujore ishin përkatësisht 1.60 dhe 0.9 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rritje mujore në *yield*-in e bonove të thesarit 6-mujore me 0.06 dhe rritje ne bonot e thesarit 12-mujore me 0.14 pikë përqindje.


Fig. 3



Normat e interesit për depozitat (%)

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-4



Normat e interesit për huatë dhe bonot

Burimi: Banka e Shqipërisë



4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2016 shënoi rritje të mjeteve valutore, me rreth 0.03 milionë euro. Tremujori i dytë i 2016-ës u mbyll me një deficit të llogarisë korrente prej 354 milionë euro, rreth 2 herë më i lartë referuar të njëjtës periudhë në një vit më parë. Në krahasim me një vit më parë, deficitin e tregtisë së mallrave u thellua me tej me 39% duke arritur në 677 milionë euro. Flukset e kapitalit, shumat e tepricave nën zërin “Llogaria kapitale” dhe “Llogaria financiare”, regjistruan një pozicion neto negativ prej rreth 246.4 milionë euro ndikuar kryesisht nga rritja e detyrimeve financiare ndaj jo rezidentëve (307 milionë euro). Karakteristika strukturore e Bilancit të Pagesave paraqitet në figurën 5.

Llogaria korrente për tremujorin e dytë të vitit 2016 thelloi deficitin e saj në rreth 354 milionë euro, ose 2 herë më të larta referuar tremujorit të dytë në vitin 2015. Thellimi i deficitit korrent i atribuohet tërësisht zgjerimit të deficitit tregtar në mallra, me rreth 189 milionë euro ndërkohë që, përbërësit e tjerë të llogarisë korrente shënuan ndikime të papërfillshme. Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente prej 258 milionë euro shprehet sipas elementeve kryesore përbërës (në terma neto) për vitin 2016:


- (i) bilanci tregtar me -677.1.1 milionë euro,
- (ii) shërbime neto me 121.9 milionë euro,
- (iii) të ardhura neto me 15.2 milionë euro,
- (iv) transfertat neto me 216.6 milionë euro.

Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.




5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit shtator 2016, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 77,870 miliardë lekë krahasuar me muajin shtator të vitit 2015. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 53,415 miliardë lekë dhe të Bankës së Shqipërisë me rreth 24,455 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto.



Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3, arriti në 1,230,848.7 milionë lekë në muajin shtator, duke shënuar rritje prej rreth 2.7 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në muajin shtator 2016, sistemi bankar rezulton me një **rritje** prej 3,247 miliardë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin gusht 2016.





6. Kredia për Ekonominë

Totali i kredisë për ekonominë për muajin shtator 2016 arriti në 549,225 miliardë lekë. Teprica e kredisë, krahasuar me muajin shtator 2015 shënoi rënie me vlerë 2,924.9 miliardë lekë, pra rritje prej rreth 0.54 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 53.8 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 295,527 milionë lekë.

Gjatë muajit shtator 2016, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 62.9 për qind ose 345,524 milionë lekë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 30.4 për qind ose 166,948 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.9 dhe 1.64 për qind apo 26,871 dhe 9,019 milionë lekë.


Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin shtator 2016, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 50.69 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 38.19 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.40 për qind dhe rreth 23.71 për qind.



7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin shtator 2016 shënoi rënie me 0.02 për qind krahasuar me muajin paraardhës gusht 2016. Kjo ofertë arriti në rreth 236,152.1 milionë lekë në fund të muajit shtator 2016, duke shënuar një rritje vjetore kundrejt nivelit të regjistruar në muajin shtator 2015 prej 0.35 për qind.

Fig-11




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare për muajin shtator 2016, kanë pësuar rënie prej 11,758.7 milionë lekë në krahasim me muajin shtator 2015. Sektori i Individëve ka zënë rreth 87.1 për qind të tyre.

Fig-12



Raporti i Depozitave ndaj M3


Burimi: Banka e Shqipërisë

Ndërsa depozitat në valutë gjatë muajit shtator 2016 shënuan rritje prej 33,337.1 milionë lekë, mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 84.0 për qind të depozitave në valutë.

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit shtator 2016, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 86.5 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.7 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 1.6 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 83.1 për qind dhe rreth 14.5 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 86.5 për qind e totalit.

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në total, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe me rreth 842,872.2 milionë lekë të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (121,056.9 milionë lekë), “Korporata jofinanciare publike” (14,706.9 milionë lekë) dhe “Korporata të tjera financiare” (13,944.7 milionë lekë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 2,116.6 milionë lekë në totalin e depozitave.

Fig-14



Përberja e depozitave Shtator 2016

Burimi: Banka e Shqipërisë

Gjatë muajit shtator 2016, niveli i përgjithshëm i depozitave arriti vlerën 994,697 milionë lekë. Krahasuar me një muaj më parë niveli i depozitave shënoi rritje prej 1,474.0 milionë, ndërsa krahasuar me një vit më parë totali i depozitave ka shënuar gjithashtu rritje me 21,578 milionë lekë.


Sektori Fiskal

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-shtator 2016 janë mbledhur rreth 298.4 miliardë lekë të ardhura, përkundërt shpenzimeve të përgjithshme prej 287.9 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 252.8 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe rreth 35.0 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat rreth 55% janë financime të brendshme.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 203.9 miliardë lekë (ose rreth 99% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 11.6 miliardë lekë (ose rreth 103% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 57.3 miliardë lekë (ose rreth 99% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 17.5 miliardë lekë (ose rreth 94% e planit të periudhës janar-shtator).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 252.8 miliardë lekë, 50.0 miliardë lekë (20% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 25.7 miliardë lekë (10%) për interesat, 27.4 miliardë lekë (11%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.1



miliardë lekë (0.01%) për subvencione, 106.7 miliardë lekë (42.2%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 26.0 miliardë lekë (10.3%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 14.5 miliardë lekë (5.7%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 71% (shpenzime personeli), 60% (shpenzime për interesat), 63% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 64% (subvencione), 71% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 54% (për shpenzimet e qeverisjes vendore) dhe 62% (shpenzimet e tjera) përkundërt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishin 57%, ndërsa financimi i huaj është 65% e planifikimit të tyre vjetor.

2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-shtator 2016 ishin rreth 298.4 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 274.3 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 17.5 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat gjatë periudhës Janar-Shtator 2016 (mld Lekë)
Revenues during January-September 2016 (in billion ALL)

Burimi (Source)	Shtator '16 September '16	Shtator'15 September'15	Ndrysh(%) Chang (%)
TVSH (VAT)	96.2	90.8	8.5
Tatimi mbi fitimin (Profit Tax)	21.7	18.3	18.7
Taksa doganore (Custom Tax)	4.4	4.1	5.7
Taksat nacionale (National Tax)	24.1	22.2	8.3
Akcizat (Excise)	30.9	29.5	4.9
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP) / (Income Tax)	24.4	21.9	11.1

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: Nëntor – 2016;

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: November – 2016;

1. Financimi i Bilancit Fiskal

Suficiti prej 10.5 miliardë lekë, përgjatë periudhës janar-shtator 2016, u përdor kryesisht për pagesën e maturimit të huamarrjes së brendshme (rreth -28.5 miliardë lekë) dhe nëpërmjet huasë afatgjatë të huaj (rreth 18.0 miliardë lekë).

Për muajin shtator 2016, disa nga treguesit kryesor fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 32.024 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 33.896 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin shtator 2016, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat arrijnë shifrën e 29.7 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 29.3 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 4.5 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2011	2012	2013	2014	2015	2016	
Janar	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	0.9	0.80	0.7	1.00	0.8	1.4	0.9	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	1.5	January
Shkurt	2.3	1.3	1.1	1.4	2.4	1.1	1.55	1.0	1.05	1.1	1.9	1.0	4.5	0.6	2.5	1.9	2.3	0.2	February
Mars	-0.1	0.4	0.2	0.5	0.4	0.5	1.00	0.8	0.77	0.9	1.4	0.7	4.3	1.0	2.4	2.2	2.2	0.3	March
Prill	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6	-0.5	-0.4	0.60	0.6	0.55	0.5	0.9	0.5	4.1	1.6	2.3	1.7	2.3	0.3	April
Maj	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1	-1.6	-1.2	0.26	0.3	0.24	0.2	0.3	0.2	4.2	1.9	2.1	1.6	1.8	0.7	May
Qershor	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7	-1.1	-0.6	0.04	0.1	0.15	0.1	0.1	0.04	3.9	2.2	2.3	1.5	1.4	1.2	June
Korrik	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6	-0.7	0.05	-0.07	0.1	-0.03	0.0	0.1	-0.10	3.6	2.7	1.6	1.8	1.3	1.9	July
Gusht	0.3	0.4	-0.1	0.1	0.8	0.86	-0.02	0.1	-0.04	0.0	0.1	-0.15	3.1	2.8	1.2	2.0	1.9	2.0	August
Shtator	0.4	0.2	0.8	0.3	0.6	0.40	0.02	0.1	0.06	0.0	0.2	-0.16	2.8	2.6	1.7	1.5	2.2	1.8	September
Tetor	0.4	0.2	0.1	0.1	0.01		0.06	0.1	0.05	0.0	0.2		3.0	2.4	1.7	1.4	2.1		October
Nëntor	0.1	0.2	-0.5	-0.2	-0.3		0.06	0.1	0.01	0.0	0.1		2.9	2.5	1.0	1.7	2.1		November
Dhjetor	1.0	0.9	1.7	0.7	0.6		0.14	0.2	0.15	0.1	0.17		1.7	2.4	1.9	0.7	2.0		December

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**
Exchange rate

Monedha	2011	2012	2013	2014	2015	2016										Currency
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator		
<i>Mesatarja e periudhës</i>																<i>Average of period</i>
USD	100.90	108.18	105.67	113.64	126.64	127.37	124.70	124.56	122.21	122.35	122.76	123.37	121.79	122.50	USD	
EURO	140.33	139.04	140.27	140.11	137.65	138.35	138.33	138.22	138.51	138.32	137.92	136.57	136.51	137.34	EURO	
<i>Fundi i periudhës</i>																<i>In the end of period</i>
USD	107.54	105.85	101.86	115.23	125.79	127.06	126.59	122.26	121.56	124.15	123.50	122.60	123.34	122.74	USD	
EURO	138.93	139.59	140.20	140.14	137.28	138.68	138.24	138.77	138.29	138.32	137.33	136.18	137.52	137.33	EURO	

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3 **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**
Annual Interest Rates (in ALL)

	2011	2012	2013	2014	2015	2016										In percent
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator		
Në përqindje						Jan	Feb	Mar	Apr	May	June	July	August	September		
Norma e depozitave																Deposits rates
12-M	5.87	5.38	4.17	1.51	1.27	1.18	1.15	1.07	0.93	0.84	0.73	0.70	0.54	0.72	12-M	
6-M	4.87	4.50	3.40	1.16	1.17	0.90	0.74	0.78	0.65	0.67	0.54	0.58	0.67	0.54	6-M	
3-M	4.22	3.83	2.72	0.83	0.54	0.50	0.51	0.39	0.33	0.29	0.28	0.28	0.29	0.27	3-M	
1-M	4.39	3.62	2.79	1.47	0.88	1.14	0.56	0.49	0.72	0.67	0.72	0.71	0.57	0.79	1-M	
Norma e huasë																Lending rates
12-M	11.17	10.28	9.52	7.00	7.47	8.29	7.31	7.47	4.29	8.30	7.19	7.19	7.72	13.18	12-M	
6-M	12.28	10.61	9.59	8.18	8.35	9.24	9.48	9.28	9.67	9.79	10.08	9.30	11.04	10.04	6-M	
Norma e letrave me vlerë																Securities rates
Bono thesari 1/																Treasury bills 1/
3-M	5.31	5.03	3.40	3.15	-	1.45	-	-	0.90	-	-	0.88	-	-	3-M	
6-M	6.23	5.65	3.54	3.16	2.46	1.99	1.36	1.26	1.15	0.99	0.95	0.94	0.86	0.90	6-M	
12-M	6.95	6.37	3.66	3.33	2.40	2.10	1.78	1.63	1.52	1.35	1.28	1.29	1.46	1.60	12-M	

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2016

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M E R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	32,829	61,725	96,639	131,304	164,324	198,316	233,202	266,453	298,477	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	335	1,655	2,542	3,303	3,895	4,149	5,189	5,989	6,575	Grants
II.	Të ardhura tatimore	29,799	55,728	88,166	119,583	150,151	180,716	213,224	244,516	274,315	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	21,355	40,944	66,560	88,241	110,315	133,672	157,489	181,643	203,977	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	10,195	19,861	29,912	40,474	51,357	62,830	74,104	85,658	96,282	V. A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,556	3,416	10,787	12,814	14,551	16,522	18,113	19,821	21,733	Profit Tax
3	Akcizat	2,789	5,561	8,588	11,967	15,385	19,201	23,407	27,565	30,979	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	3,345	5,752	7,967	10,553	13,429	16,022	19,031	22,098	24,407	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	3,072	5,546	7,999	10,659	13,286	16,200	19,401	22,538	26,139	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	398	808	1,307	1,774	2,307	2,852	3,433	3,963	4,437	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	643	1,202	2,217	4,193	6,784	8,125	9,137	10,233	11,624	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (nëndësat)	193	351	650	1,438	2,316	2,880	3,196	3,530	3,827	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	74	170	431	493	519	543	554	558	565	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	376	681	1,136	2,262	3,949	4,702	5,387	6,145	7,232	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	7,801	13,582	19,389	27,149	33,052	38,964	46,598	52,640	58,714	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	6,551	11,371	16,242	22,714	27,677	32,704	39,098	44,220	49,315	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndësor	1,144	1,895	2,630	3,752	4,556	5,326	6,429	7,208	8,070	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	106	316	517	683	819	934	1,071	1,212	1,329	Revenues for property compensation
III.	Të ardhura Jotatimore	2,695	4,342	5,931	8,418	10,278	13,451	14,789	15,948	17,587	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë				1,095	1,095	1,095	1,095	1,095	1,095	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,006	3,113	4,223	5,490	6,923	9,423	10,279	10,992	11,988	Income of budgetary institutions
3	Dividenti		2	2	10	11	21	23	70	71	Divident
4	Tarifat shërbimeve	513	653	788	1,004	1,155	1,346	1,590	1,768	2,044	Tariffs on services
5	Të tjera	176	574	918	819	1,094	1,568	1,802	2,023	2,389	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	23,898	51,678	83,547	116,144	146,727	182,129	216,081	254,073	287,969	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	22,490	48,531	75,313	103,951	131,644	162,021	192,303	223,507	252,873	Current Expenditures
I.1	Personell	5,430	10,918	16,463	22,061	27,622	33,228	38,915	44,548	50,097	Personnel expenditures
1	Paqa	4,657	9,376	14,148	18,965	23,755	28,573	33,490	38,355	43,141	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	773	1,542	2,315	3,096	3,867	4,655	5,425	6,193	6,956	Social insurance contributions
I.2	Interesat	3,305	6,576	9,282	12,174	14,776	17,451	20,561	23,474	25,745	Interest
1	Të Brendshme	2,481	5,105	7,338	9,572	11,715	13,819	16,158	18,466	20,324	Domestic
2	Të Huaja	824	1,471	1,944	2,602	3,061	3,632	4,403	5,008	5,421	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,204	3,752	6,528	9,376	12,362	16,535	20,213	23,566	27,479	Operational & Maintenance
I.4	Subveclonet	54	100	273	339	417	631	811	972	1,120	Subsidies
I.6	Shpenzime për fonde speciale	10,264	21,510	32,856	44,843	56,958	69,347	81,575	95,397	107,847	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	8,332	16,643	25,362	34,245	43,089	52,478	62,056	72,293	81,747	Social insurance
2	Sigurime Shëndësore	1,932	4,669	7,296	10,400	13,434	16,434	19,084	22,013	25,009	Health insurance
3	Fondi i kompensimit te pronareve		198	198	198	435	435	435	1,091	1,091	expenditures for Owners Compensation
I.7	Shpenzime per Buxhetin Vendor	1,399	3,365	5,729	9,122	11,761	15,366	19,002	22,694	26,047	Local budget expenditure
I.8	Shpenzime të tjera	834	2,310	4,182	6,036	7,748	9,463	11,226	12,856	14,538	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	41	85	133	188	262	334	406	471	532	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	801	1,956	3,782	5,552	7,002	8,615	10,125	11,507	13,057	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përdjekurve politike	-8	269	267	296	484	514	695	878	949	Compensation for ex-political prisoners
III	Shpenzime Kapitale	1,408	3,147	8,234	12,193	15,083	20,108	23,630	30,566	35,096	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	46	474	4,020	6,247	7,825	10,749	12,707	16,705	19,439	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,362	2,673	4,214	5,946	7,258	9,343	10,923	13,861	15,657	Foreign financed
V.	DEFICITI	8,931	10,047	13,092	15,160	17,597	16,187	17,268	12,380	10,508	CASH BALANCE
V.1	FINANCIMI DEFICITIT	-8,931	-10,047	-13,092	-15,160	-17,597	-16,187	-17,268	-12,380	-10,508	CASH BALANCE FINANCING
V.2	Brendshëm	-9,154	-19,525	-22,154	-19,814	-26,455	-25,947	-26,823	-28,467	-28,516	Domestic
1	Të ardhura nga privatizimi	204	207	358	364	385	2,609	2,611	2,612	2,614	Privatization receipts
2	Hua-marrje e brendshme	2,503	3,818	5,249	9,435	13,920	14,017	13,703	12,456	8,474	Domestic new borrowing (net)
2.1	Nacionale	2,513	3,835	5,273	9,467	13,934	14,036	13,731	12,488	8,536	Other
2.2	Lokale	-10	-16	-24	-32	-14	-19	-28	-32	-62	Foreign
3	Të tjera	-11,861	-23,550	-27,761	-29,613	-40,760	-42,573	-43,137	-43,535	-39,604	Other
4	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-499	-14,410	-11,935	-16,301	-30,275	-29,535	-31,135	-32,107	-28,497	Government deposits into the Central Bank
5	Të tjera	-11,362	-9,140	-15,822	-13,312	-10,487	-12,887	-12,002	-11,428	-11,107	Other
6	Depozita e ISSH dhe ISKSH	-2,759	-1,391	-4,083	-4,595	-4,261	-4,681	-3,940	-4,015	-3,640	deposits of Social and Health insurance
7	Mjete në ruajtje	-187	-93	-253	-649	1,590	-566	-828	-733	-740	Preservation stock
8	Nënhua	94	160	269	654	755	1,064	1,166	1,220	1,329	On-Loan Principal
9	Detyrim ndaj ISSH	660	1,725	-287	1,152	934	8	2,219	397	502	Liabilities to SSI
10	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-432	-544	-568	-586	-600	6	0	-11	-14	Other-Floating
V.3	I huaj	223	9,478	9,062	4,654	8,858	9,760	9,555	16,087	18,008	Foreign
1	Hua afatgjatë(e marrë)	4,210	3,040	3,879	4,992	5,907	8,345	9,387	11,344	12,512	Long-term foreign borrowing (gross)
2	Nga e cila nënhua	242	418	857	1,128	984	3,438	3,872	4,874	5,101	Subsidiary Loan
3	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-3,182	-2,020	-1,983	-1,860	-2,054	-2,496	-2,832	-2,352	-2,303	Change of stat. Account
4	Ripagesat	-805	-1,584	-2,876	-8,520	-10,021	-12,283	-13,194	-14,031	-15,142	Repayments
5	Mbështetje Buxhetore	0	10042	10042	10042	15026	16194	16194	21126	22941	Budgetary Support

Tab - 5

Tabela e investimeve 2016

Table of investments 2016

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	
Financim i brendshëm	46	474	4,020	6,247	7,825	10,749	12,707	16,705	19,439	Domestic financing
Në %	3.27	15.06	48.82	51.23	51.88	53.50	53.77	54.65	55.39	In %
Financim i huaj	1,362	2,673	4,214	5,946	7,258	9,343	10,923	13,861	15,657	Foreign financing
Në %	96.73	84.94	51.18	48.77	48.12	46.50	46.23	45.35	44.61	In %
Totali	1,408	3,147	8,234	12,193	15,083	20,092	23,630	30,566	35,096	Total
Në %	100	100	100	100	100	100	100	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2016 (CUSTOMS REVENUES 2016)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill April	Maj May	Qershor June	Korrik July	Gusht August	Shtator September	
